



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	5297 Nr. i faq/Br.str/No.pg 32
Data/Datum/Date	13 / 02 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028

1. Caktohet grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ekrem Bytyqi, kryesues;
 - 1.2. Skender Hamza, anëtar, procesmbajtës;
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar, procesmbajtës;
 - 1.4. Egzon Thaqi, anëtar, procesmbajtës;
 - 1.5. Izet Morina, anëtar, përgatitja e materialeve;
 - 1.6. Alban Gashi, anëtar, listat e nënshkrimeve;
 - 1.7. Blerta Gashi, anëtare, moderatore;
 - 1.8. Albion Krasniqi, anëtar, procesmbajtës;
 - 1.9. Qëndresa Kryeziu-Hoxha, anëtare, procesmbajtës;
 - 1.10. Dafina Gashi, anëtare, moderatore;
 - 1.11. Kaltrina Duraku, anëtare, listat e nënshkrimeve;
 - 1.12. Ardit Halilaj, anëtar, fotograf;
 - 1.13. Almedina Jaha, anëtare, fotografe;
 - 1.14. Agnesa Ramadani, anëtare, përgatitja e materialeve.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë projekt-buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028, ta bëjë hartimin e planit të brendshëm komunal për mbarrëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, ta bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ta caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe ta bëjë hartimin e tij në afatin ligjor, që parashihen në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, ta bëjë hartimin e raportit nga dëgjimet buxhetore dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komuna.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën anëtarët e grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr.Prot.02/4422 /2024, i datës 8.7.2024.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Anëtarëve të grupit punues, dhe***
- ***Arkivit.***

